

GEORG STADTMÜLLER. *Forschungen zur albanoschen Frühgeschichte*, Zweite erweiterte Aufgabe. Oto Harrassowitz, Wiesbaden 1966 pp XXX-221.

Georg Stadtmüller, drejtor i Institutit të historisë së Evropës Lindore dhe Juglindore dhe poashtu shef i Katedrës së historisë së popujve të Evropës Lindore dhe Juglindore të Universitetit të Mënhenit, nxanës i shkencëtarit të madh austriak Karl Patschit, të cilit ia dedikon edhe veprën në fjalë, me një akribi në kuptimin e plotë të fjalës, merret me studimin dhe ndriçimin e periudhave ma të errëta dhe ma të ndërlikueme të historisë së hershme shqiptare. Fryt i kësaj pune asht vepra e tij *Forschungen zur albanischen Frühgeschichte* (Kërkime mbi historinë e vjetër shqiptare), e cila u botue së pari në edicionin *Archivium Europae Centro — Orientalis*⁷ (1941) 1—196, të Akademisë Hungareze të shkencave, kurse si libër i veçantë botohet më 1942.

Meqenëse një pjesë e kësaj vepre humbi gjatë Luftës së dytë botnore, ajo u botue përsëri nën kujdesin e autorit dhe në edicionin e *Albanischen Forschungen* 2. Në krahasim me të parin botimi i dytë dallohet përkrah plotësimi i numrit të bibliografisë së re lidhë me problemin që trajtohet dhe me të dhana ma të reja mbi problemet e historisë së hershme të popullit shqiptar.

Mbas parathanjes (IX—XI) dhe hymjes së gjatë (XIII—XXX), pason ndamja e librit në tetë kaptina (4—179), mandej pasqyra e autorëve dhe veprave që trajtojnë problemin në fjalë (180—202) dhe në fund treguesi analitik (203—221). Libri ilustruhet edhe me dy harta, të cilat paraqesin rrugët dhe depërtimin romak, si dhe vendbanimet sllave në Shqipni.

Në kaptinën e parë (9—37) bahet fjalë për vendin, detyrën dhe randësinë historike të kërkimeve në Shqipni, në kaptinën e dytë (38—46) për historinë e „Çashtjes shqiptare“, kurse në të tretën (47—54) flitet në mënyrë kritike mbi zgjedhjen e deritashme të „Çashtjes shqiptare“ dhe metodën që asht përdorë deri tash në zgjidhjen e problemit. Në kaptinën e katërt (55—75) bahet fjalë për periudhën parashqiptare, respektivisht pararomake. Kaptina e pestë (76—124) e cila në krahasim me të tjerat asht ma e gjata, ka të bajë me periudhën e vjetër të historisë shqiptare, gjegjësisht flet për periudhën e sundimit romak dhe për periudhën e hershme bizantine. Pos tjerash, në te bahet fjalë për metodën e hulumtimeve; huazimet latine në shqipet; huazimet e greqishtes së vjetër në shqipet; krishtenizimin e shqiptarëve të vjetër; mbeturinat e gjuhës së vjetër shqipe si relikte të vendbanimeve; emnat latine të vendeve; vendbanimet dhe rrugët romake; regjionin kultural romako-grek; Matin dhe rrethin e tij si pikënisje të vendbanimit dhe të shtrimjes së shqiptarëve të vjetër në të katër anët. Poashtu edhe kaptina e gjashtë ndahet në disa nëntituj (125—159), në të cilën trajtohet periudha e hershme shqiptare (rreth 600—1018). Ndër të tjerë, në te flitet për metodën e hulumtimeve; distriktet kishtarë; huazimet sllave; emnat sllave të vendeve. Në kaptinën e shtatë (160—173) autori flet për *dëshmit* e para historike në të cilat bahet fjalë për shqiptarët, sidomos në shek. XI—XIII-të. Këtu ka të bajë me të dhanat e autorëve bizantinë të cilët në veprat e tyre i përmendin shqiptarët, si bie fjala Anna Komnena etj., kurse në kaptinën e fundit flitet për emnin kombëtar „Arbër“ (174—179).

Simbas Georg Stadtmüllerit, vendbanimi i hershëm i shqiptarëve duhet të kërkohet në viset e Matit, gjegjësisht në Alpet e Shqipnisë që shtrihen rreth e përqark Matit. Këtu shqiptarët të organizuem në fise fillojnë të përhapen. Kjo përhapje mund të përcillet rreth shekullit XIII dhe sidomos në drejtim të Jugut, në Greqinë e sotme.

Megjithatë, mendojmë se kjo vepër nuk asht edhe fjala e fundit e autorit të shquem në rrahjen e problemit kaq të koklavitun dhe të ndërlikuem sikur që asht edhe etnogjeneza e popullit shqiptar. Jemi të bindun se edhe vetë autori asht i vetëdijshtëm se akoma ekzistojnë errsina të mëdha të cilat, pa pasione dhe me një punë të përbashkët dhe shkencore, duhet të ndriçohen meqenëse mu për këtë periudhë burimet historike heshtin. Por,

„argumenta ex silentio ad hoc non vaient!” Dihet se historia nuk njihet kapërcime dhe shmangëje! Mungesën e dokumenteve të shkrueme dita ditës po e plotsojnë të dhanat arkeologjike në Shqipëri, që po zbulohen sistematikisht gjatë viteve të fundit. Përkundrazi kjo kulturë materiale, të cilën arkeologët shqiptarë po e zbulojnë, e cila në mos identike, atëherë asht shumë e ngjashme në të katër anët e trevës shqiptare, pa marrë parasysh konfiguracionin gjeografik të vendit, plotësisht na bind se problemin e historisë së hershme shqiptare duhet ta shqyrtojmë, jo nga aspekti i ekzistencës së tyre prej një qendre, por në realitet nga aspekti i restriksionit të tyre në një qendër, gjegjësisht në viset e pakalueshme dhe të vështira për kambën pushtuese.

Në fund duhet të themi se vepra e Georg Stadtmüllerit, e pajisun me një aparat shkencor të pasun dhe e përpilime me një metodologji të qartë dhe koncize, zën një ndër vendet më të rëndësishme në orvatjet e historiografisë në përgjithësi në shtjellimin e problemit të historisë së hershme të popullit shqiptar. Sido që të jetë, duhet të jemi mirënjohës edhe pse ndoshta disa prej konceptioneve të tij me kohë kanë për t'u shndërrue ose plotësue në saje të hulumtimeve të mavonshme dhe të studimit e të analizës së kulturës materiale, e cila dita ditës, sikur që tham, po del në dritë.

Sidoqoftë, Georg Stadtmüllerit me veprën e vet dhe akribinë e tij shkencore, çka shihet qartë në përpilimin e kësaj vepre, paraqitet si një ndër njohësit më të mirë dhe më të mëdhej të historisë së hershme shqiptare.

ZEF MIRDITA